

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial

P2

Nr.

FLETË PROVIMI

Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 28.01.2023

Problemi 1

a) Kostoja sipas metodës marxhinale dhe kostoja sipas metodës së absorbimit janë teknika të menaxhimit të kostos që përdoren për të shpërndarë (alokuar) koston tek produktet e prodhuara për vlerësimin e tyre. Ka dallime (ndryshime) në fitimin operativ kur aplikohet kostoja marxhinale ose ajo e absorbimit.

Kërkohet:

Tregoni DY (2) arsye që tregojnë për diferencat (dallimet) në fitimin operativ sipas sistemeve të kostos marxhinale dhe të absorbimit. **(4 pikë)**

b) ABC Ltd është një prodhues i produktit Wale. Në një periudhë, ABC LTD prodhoi 20,000 njësi dhe shiti 18,000 njësi. Çmimi i shitjes për njësi të prodhimit është €5. Në periudhën e planifikuar të prodhimit, të dhënat përkatëse të kostos dhe të të hyrave janë deklaruar si:

	€
Shitjet	100,000
Kostot e prodhimit:	
Variabile	35,000
Fikse	15,000
Shpenzimet administrative dhe shitjes:	
Fikse	25,000

Kërkohet:

Përgatitsi një pasqyrë të të ardhurave bazuar në sistemet e mëposhtme të kostos:

i) Sistemin marxhinal të kostove.

(8 pikë)

ii) Sistemin abosrbues të kostove.

(8 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhje Problemi 2

a) Faktorët që ndikojnë në dallime në fitim operativ:

SHPP fikse. Sistemi i koston marxhinale përjashton shpenzimet fikse të prodhimit nga vlerësimi i stokut ndërsa, sistemi i koston së përthithjes (abosrbimit) përfshin shpenzimet fikse të prodhimit në vlerësimin e stokut.

Diferencat në stokun përfundimtarë. diferencat në vlerat e stoqeve mbyllëse mund të shkaktojnë diferenca(a) në fitimin e raportuar si në koston marxhinale ashtu edhe në atë të abosrbimit.

b)

i) Kosto marxhinale për njësi

Kosto marxhinale/prodhimi total

= €35,000 / 20,000 njësi

= €1.75

Pasqyra e të ardhurave sipas sistemit marxhinal

	€
Shitjet (18,000 x €5)	90,000
Minus koston marxhinale të prodhimit:	
Koston variabile të prodhimit	35,000
Stoku mbyllës (20,000 - 18,000) 2,000 x €1.75	(3,500)
Kosto marxhinale totale	(31,500)
Kontributi	58,500
Minus, Kosto fikse prodhimit:	
Kosto fikse e prodhimit	15,000
Kostit fikse të shitjes dhe administrative	25,000
Shpenzimet totale	<u>(40,000)</u>
Fitimi neto	18,500

(8pikë)

ii) Kosto e absorbimit për njësi

= Kosto e plotë e prodhimit/prodhimi total

= €50,000 / 20,000 njësi

= €2.5

Pasqyra e të ardhurave sipas sistemit abosrbues

	(€)
Shitjet (18,000 x €5)	90,000
Minus, koston e prodhimit:	
Koston variabile të prodhimit	35,000
Fikse	15,000
Stoku mbyllës (20,000 - 18,000) 2,000 x €2.5	(5,000)
Kosto totale e prodhimit	(45,000)
Fitimi bruto	45,000
Minus, shpenzimet e shitjes dhe administrative	<u>(25,000)</u>
Fitimi neto	20,000

Problemi 2

ABC Ltd merret me prodhimin dhe tregtimin e dy produkteve, përkatësisht: Produkti A dhe Produkti B. ABC Ltd aktualisht është në procesin e përgatitjes së buxheteve për vitin që përfundon më 31 mars 2023, dhe informacioni i mëposhtëm është vlerësuar.

Blerjet:

Kosto për njësi - materialet:

	Product A
Materiali X (€200 për Kg)	€550

Shitjet:

Janë parashikuar shitjet tremujore si në vijim. Shitjet mujore shpërndahen në mënyrë të barabartë brenda çdo tremujori.

	Prill- Qershor 2022	Korrik- Shtator 2022	Tetor- Dhjetoe 2022	Janar-Mars 2023	Prill- Qershor 2023
Product A (Njësi)	84,000	88,200	93,000	96,000	100,800
Product B (Njësi)	63,000	66,000	67,800	69,000	72,000

Informata shitesë:

-ABC Ltd aplikon metodën FIFO dhe mban një të materialeve prej 20% të kërkesës së prodhimit të tremujorit vijues (pasues).

-Politika e kompanisë është të mbajë një nivel të produkteve të gatshme në fund të muajit të barabartë me 50% të shitjeve të muajit vijues (pasues).

Kërkohet:

- Përgatitni një plan të prodhimit në njësi për Produktet A dhe B veçmas në baza tremujore, për vitin që përfundon më 31 mars 2023. **(9 pikë)**
- Përgatitni buxhetin e blerjes së materialit për materialin X në sasi, për tre tremujorët e parë, vetëm për produktin A. **(7 pikë)**
- Identifikoni KATËR (4) përfitime që ABC do të përfitojë nga përgatitja e buxheteve. **(4 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhje problemi 2

a) Plani i prodhimit për produktin A dhe B

	Prill-Qershor 2022	Korrik-Shtator 2022	Tetor- Dhjetoe 2022	Janar-Mars 2023
Produkti A				
Shitjet	84,000	88,200	93,000	96,000
+ : Stoku mbylles	14,700	15,500	16,000	16,800
- : Stoku hapës	(14,000)	(14,700)	(15,500)	(16,000)
Prodhimi	84,700	89,000	93,500	96,800
Produkti B				
Shitjet	63,000	66,000	67,800	69,000
+ : Stoku mbylles	11,000	11,300	11,500	12,000
- : Stoku hapës	(10,500)	(11,000)	(11,300)	(11,500)
Prodhimi	63,500	66,300	68,000	69,500

(9 pikë)

b) Material X Purchase budget (in kgs)

	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetoe	Total
Prodhimi	84,700	89,000	93,500	96,800
	2.75	2.75	2.75	2.75
	323,925	244,750	257,125	266,200
+ : Stoku mbylles	48,950	51,425	53,240	
	281,875	296,175	310,365	
- : Stoku hapës	46,585	48,950	51,425	
	235,290	247,225	258,940	

c) Përfitimet nga përgatitja e buxheteve:

- Të planifikohen paraprakisht operacionet
- Të koordinohen aktivitetet e pjesëve të ndryshme të një organizate për një qëllim të përbashkët organizativ.
- Të komunikohen planet me menaxherët e qendrave të ndryshme të përgjegjësive
- Të motivohen menaxherët që të përpiqen për të arritur qëllimet organizative
- Të krahasohen rezultatet aktuale me buxhetin dhe të merren masa kontrolluese.

Problemi 3

a) Kontabiliteti i Menaxherial është ajo degë e kontabilitetit e njohur për vendimmarrje të menaxhmentit. Është një bashkim më intim i dy profesioneve më të vjetra të menaxhimit dhe kontabilitetit, ku nevojat për informacion të menaxherit përcaktojnë mjetet kontabël për kënaqësinë e tyre.

Kërkohet:

- i) Identifikoni TRE (3) objektiva të Kontabilitetit të Menaxhmentit. **(6 pikë)**
- ii) Shpjegoni PESË (5) cilësi të informacionit të kontabilitetit të menaxhmentit. **(5 pikë)**

b) Kontrolli operacional dhe qasjet e menaxhimit të kontrollit të kostos nevojiten për të shtuar njohuri se ku dhe si mund të implementohen përmirësimet e kostove.

Kërkohet:

Bëni dallimin ndërmjet *kostove operacionale* dhe *kontrollit të kostove*. **(4 pikë)**

c) Metodatat specifike të kostos së porosisë janë të përshtatshme për organizatat e biznesit të cilat janë të përfshira në ndërtimin, prodhimin ose montimin e produkteve sipas specifikave të klientëve individualë.

Kërkohet:

Tregoni TRE (3) karakteristika të Kostos Specifike të Porosisë. **(5 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidha e problemit 3

a)

i) Objektivat e kontabilitetit të menaxhmentit

- Planifikimi; vendosjen e objektivave të organizatës dhe hartimin e masave për të siguruar arritjen e tyre.
- Kontrolli; monitorimin e performancës aktuale dhe krahasimin e saj me planin për të ndërmarrë veprime për devijimet.
- Vendimet tjera; japin informacion mbi vendimet afatgjata dhe afatshkurtra. P.sh. bëj ose blej, çmimi special, eliminimi i segmentit.

ii) Informacioni i kontabilitetit të menaxhmentit duhet të jetë në përputhje me një numër të ndryshëm cilësish, duke përfshirë: verifikueshmëria, objektiviteti, afati kohor, krahasueshmëria, besueshmëria, kuptueshmëria dhe rëndësia nëse do të jetë e dobishme në planifikim, kontroll dhe vendimmarrje.

b) Kostot operacionale (kontrolli operacional); një sistem i vendosur për të siguruar që aktivitetet e përditshme drejtohen drejt rezultatit të pritur. Kontrolli i kostos; ku kostot monitorohen për të siguruar që ato të jenë në përputhje me të planifikuara.

c) Karakteristikat e kostos specifike të porosisë.

- Kostoja e secilit objekt kostoje llogaritet veçmas.
- Shpenzimet klasifikohen në elemente të kostos dhe gjurmohen në njësi të kostos.
- Disa punë mund të kryhen në të njëjtën kohë.
- Cdo punë është identifikuar për qëllime të akumulimit të kostos.
- Kartelat e punës lëshohen për çdo punë që përmbajnë të dhënat e klientit.

Problemi 4

a) ABC prodhon tavolinë-dyshe për shkollat lokale në distriktin XIX. Për të lehtësuar kontrollin, pronari i dyqanit ju ka kërkuar JU që ta ndihmoni në analizimin e kostove, duke i ndarë ato në elementin fiks dhe variabil.

Më poshtë janë informacionet e tij financiare gjashtëvjeçare.

Year	Numri i tavolinave	Të hyrat (€)	Fitimi (€)
2016	1,800	19,600	6,000
2017	1,700	22,000	6,200
2018	1,750	20,300	5,800
2019	2,100	26,200	8,000
2020	1,950	22,400	7,500
2021	2,050	21,800	6,800

Kërkohet:

- i) Krijoni *funksionin* e kostos totale duke përdorur metodën e *poshtë-lartë*. **(5 pikë)**
- ii) Llogaritni fitimin për prodhimin dhe shitjen e 3,500 njësive nëse çmimi i shitjes është fiksuar në €20. **(3 pikë)**
- iii) Identifikoni DY (2) avantazhe dhe DY (2) disavantazhe të përdorimit të metodës poshtë-lartë. **(4 pikë)**
- iv) Identifikoni TRE (3) benefite për klasifikimin e kostos si fikse dhe variabile. **(3 pikë)**

b) Për menaxherët brenda një kompanie, ushtrimi i kontrollit nëpërmjet standardeve dhe kostos standarde është një program krijues që synon të përcaktojë nëse burimet e korporatës po përdoren në mënyrë optimale. Kostot standarde zakonisht përcaktohen gjatë procesit të kontrollit buxhetor, sepse ai përdor kostot standarde të paracaktuara (buxhetuara) për materialet direkte, punën direkte dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit.

Kërkohet:

Shpjegoni TRE (3) përfitime për një kompani që përdor koston standarde.

(5 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

a)

Kalkulimi i kostos totale		
Viti	Nr. Njësive	Kosto totale
2016	1800	19600-6000 = 13,600
2017	1700	15,800
2018	1750	14,500
2019	2100	18,200
2020	1950	14,900
2021	2050	15,000

$$b = \frac{18,200 - 15,800}{2,100 - 1,700} = € 6$$

$$18,200 = a + 6(2,100)a$$

$$= €5,600$$

i) $Y = 5,600 + 6 X$

ii) Fitimi = $20 - 6(3,500) - 5600 = € 43,400$

(iii) Përparësitë e përdorimit të metodës posht-lartë:

- Metoda është e lehtë për t'u përdorur
- Nuk nevojiten shumë të dhëna
- Vizualisht, jep drejtimin e përgjithshëm të trendit

Mangësitë e përdorimit të metodës posht-lartë

- Mund të rezultojë në varianca të larta
- Metoda nuk përdor të gjitha të dhënat e disponueshme
- Nuk mund të përdoret për më shumë se një ndryshore të pavarur
- Metoda mund të mos jetë e besueshme

i) Rëndësia e klasifikimit të kostove

- Për vendimarrje
- Të jetë në gjendje të llogarisë pikën e reduktimit
- Për vendosjen e çmimeve p.sh.,. Kosto marxhinale + Përqinda e dëshiruar e fitimit
- Ndihmon për të pasur një sistem të përshtatshëm të kostos dhe buxhetimit në një organizatë.

a) Përfitimet e kostove standarde:

Buxhetimi dhe planifikimi. Buxhetet si standarde ofrojnë bazën për planifikimin për përdorimin e burimeve organizative. Standardi çon në përsosjen e planit strategjik dhe detyron realizimin e asaj që është planifikuar. Pa standarde, burimet e një organizate mund të mos përdoren në mënyrë efektive dhe efikase.

Fiksimi i çmimeve realiste. standardet përdoren për të vendosur çmime realiste për produktin e firmës. Standardet ofrojnë bazën për përcaktimin e kostos së një zëri ose duke përdorur parimin e supozimit të kostos së plotë ose të kostos marxhinale. Standardi

realist do t'i mundësojë firmës të përcaktojë se sa do të kushtojë për të prodhuar një njësi të prodhimit dhe nëse firma do të bëjë fitim dhe sa marzh duhet t'i shtohet koston së prodhimit për të bërë një fitim..

Matja e performancës. Performanca menaxheriale mund të vlerësohet duke matur suksesin e arritjes së grupit standard. Nëse rezultatet aktuale tejkalojnë ato të përcaktuara për sa i përket pritjeve të të ardhurave, atëherë menaxhimi konsiderohet të jetë efikas dhe efektiv. Megjithatë, nëse kostot aktuale tejkalojnë ato të pritshme, atëherë menaxhmenti nuk ka qenë efikas në përdorimin e burimeve financiare të firmës siç është paracaktuar. Standardet ofrojnë matës me të cilët krahasohen kostot aktuale me ato të paracaktuara për të përcaktuar efikasitetin e performancës.

Motivoni menaxherët. Standardet realiste shërbejnë si bazë për të motivuar menaxherët funksionalë. Nëse menaxherët e divizionit përpiqen shumë për të arritur standardet e caktuara, atëherë ata do të motivohen të punojnë shumë për të arritur lartësi të mëtejshme në periudhën e ardhshme buxhetore. Që një standard të motivojë, stafi duhet të marrë pjesë në mënyrë efektive në zhvillimin e tyre. Nëse stafi nuk është i përfshirë në procesin e përcaktimit të standardeve, ata mund të mos inkurajohen të punojnë shumë për të arritur objektivat e vendosura. Kostoja standarde lejon drejtuesit të jenë të vetëdijshëm për koston, gjë që rrit efikasitetin dhe produktivitetin.

Problemi 5

(a) Kompania ABC Sh.P.K raportoi rezultatin financiar për vitin 2022 si në vijim:

Shitjet 50,000 njësi
Çmimi € ?

Kostot variabile për njësi:

Materialet direkte	€ 2.00
Puna direkte	1.75
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabile	0.50
Shpenzimet variabile të shitjes	2.25

Kostot totale fikse:

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse	€ 100,000
Shpenzimet e pagave të shitjes	125,000
Shpenzimet e pagave të administratës	50,000

Kërkohet:

(a) Kalkuloni shitjet (në sasi) në pragun e rrezikut (rentabilitetit) nëse gjatë vitit 2022 kompania realizoi një fitim prej €25,000.

(10 pikë)

(b) Supozoni se për vitin që përfundoi më 2022, duke u bazuar në sasinë e dhënë të shitjeve dhe listën e dhënë të kostove, kompania realizoi një fitim prej €25,000.

Për ta përmirësuar fitimin, është propozuar që punonjësit e sektorit të shitjes të vijojnë një trajnim specifik. Si rezultat i këtij trajnimi, shpenzimet variabile të shitjes për njësi priten të zvogëlohen për 20% nga niveli aktual, dhe shitjet të rriten për 20% nga niveli aktual.

Kërkohet:

Duke supozuar se kostot dhe shitjet kanë një sjellje të pritur, kalkuloni shumën maksimale që kompania do të jetë e gatshme ta paguaj për programin e propozuar të trajnimit.

(10 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhje Problemi 5

(a) Për të realizuar një profit prej €25,000, duhet te qëndroj ky barazim:

Të hyrat – kostot variabile – kostot fikse = fitimi i dëshiruar

$$50,000 \times \text{Çmimi} - €6.5 \times 50,000 - €275,000 = €25,000$$

$$50,000 \times \text{Çmimi} = 25,000 + 275,000 + 325,000$$

$$\text{Çmimi} = €12.50$$

Prandaj, marzha e kontributit për njësi është €12.50 – €6.50 = €6.

Nëse Q përfaqëson sasinë në piken e rentabilitetit (pragun e rrezikut), atëherë:

$$6Q = €275,000$$

$$Q = 45,833 \text{ njësi.}$$

(b) Programi i trajnimit mundëson një strukturë të re të kostos për kompaninë në fjalë. Fitimi aktual për kompaninë është €25,000. Struktura e re e kostos, para pagesës së kostove të trajnimit, do të krijoj këtë fitim:

$$\text{Shitjet } (€12.5 \times 50,000 \times 1.2) = €750,000$$

Kostot variabile:

$$\text{Prodhimit } (€4.25 \times 60,000) = €225,000$$

$$\text{Shitjes } = (€0.80 \times €2.25 \times 60,000) = €108,000$$

$$\text{Kontributi} = €387,000$$

$$\text{Kostot fikse} = €275,000$$

$$\text{Fitimi operativ} = €112,000.$$

Në mënyrë që kompania ta justifikoj programin e trajnimit dhe strukturën e re të kostove, fitimi duhet së paku të jetë aq sa ai aktual, pra €25,000.

Prandaj, shuma maksimale për të paguar për trajnime është €112,000 - €25,000 = €87,000.